



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura V**

Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri dhe të nenit 15 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 10 gusht 2016, miratoi:

**RREGULLORE Nr. 05/Rr-001 PËR MBROJTJE NGA ZJARRI**

**Neni 1**  
**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi dhe avancimi i masave dhe veprimeve për mbrojtje nga zjarri në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Kuvendi).
2. Fushëveprimi i kësaj Rregulloreje është ndërmarrja e masave për parandalimin e shkaqeve dhe përhapjen e zjarrit, me qëllim mbrojtjen e njerëzve, pasurisë dhe mjedisit.

**Neni 2**  
**Masat dhe veprimet për mbrojtje nga zjarri**

1. Me këtë Rregullore përcaktohen masat dhe veprimet për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga zjarri, e në veçanti:
  - 1.1. Masat e parandalimit, evitimit të shkaktarëve të zjarrit dhe metodat për fikjen e zjarrit;
  - 1.2. Detyrat dhe obligimet e të gjithë të punësuarve (punëmarrësve) për zbatimin e masave preventive, si dhe ndërmarrjen e masave për fikjen e zjarrit;
  - 1.3. Obligimet dhe detyrat e organeve përgjegjëse dhe punëdhënësit për sigurimin e kushteve për mbrojtje nga zjarri;

1.4. Informimin e punëtorëve për rreziqet nga shpërthimi i zjarrit në vendin e punës, si dhe mënyrën e eliminimit të këtyre rreziqeve;

1.5. Furnizimi dhe kompletimi me pajisje për sistemin e sigurisë dhe mjeteve tjera teknike për shuarjen e zjarrit, si dhe mirëmbajtja e rregullt e tyre, ashtu që të jenë çdoherë në gjendje të gatshme për përdorim;

1.6. Informimin e punëtorëve për mënyrën e mbrojtjes nga zjarri në Kuvend, zbatimin e masave dhe procedurave të parapara për mbrojtje nga zjarri dhe përgjegjësitë, në rast mosrespektimi të tyre.

### **Neni 3**

#### **Zbatimi i rregullave për mbrojtje nga zjarri**

Përgjegjës për zbatimin e rregullave dhe masave për mbrojtje nga zjarri është çdo i punësuar në Kuvend, operatori ekonomik, vizitorët, si dhe personat fizikë dhe juridikë, që për arsye të ndryshme ndodhen në ndërtesën e Kuvendit.

### **Neni 4**

#### **Organizimi për mbrojtje nga zjarri**

1. Organizimi i mbrojtjes nga zjarri në ndërtesën e Kuvendit, realizohet nga Administrata e Kuvendit (Drejtoria për Shërbime Teknike), Njësia për Sigurimin e Objekteve Qeveritare (tutje: NJSPKQ) – Objekti Presidencë – Kuvend – Qeveri, Policisë së Kosovës, si dhe operatorët ekonomikë të kontraktuar.

2. Menaxherët përkatës të Administratës së Kuvendit, në kuadër të kompetencave të veta nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri, kryejnë këto detyra:

2.1. Urdhërojnë varësit e tyre në largimin e mbeturinave nga ndërtesa e Kuvendit, të cilat kanë mbetur si pasoje e procesit të punëve apo janë vendosur në vendet e ndaluara;

2.2. Largojnë lëndët nga vendi apo mjedisi i punës, të cilat paraqesin rrezik për shpërthim të zjarrit;

2.3. Në mënyrë të rregullt, kërkojnë servisimin e aparateve dhe pajisjeve tjera për fikjen e zjarrit;

3. Hyrjet, daljet, kalimet dhe shkallët në ndërtesë, duhet të jenë gjithmonë të lira për kalim sipas skemës dhe planit të evakuimit;

4. NJSPKQ siguron kujdestari 24 (njëzet e katër) orë për shtatë ditë (24/7) në javë, për mbrojtjen e ndërtesës nga zjarri.



## Neni 5

### Masat për parandalimin e zjarrit

1. Me qëllim të evitimit të shkaqeve të zjarrit, shpërthimit dhe zgjerimit të zjarrit, shpëtimit të njerëzve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri në ndërtesën e Kuvendit, si dhe hapësirat përreth, aplikohen këto masa të mbrojtjes nga zjarri:

1.1. Gjatë projektimit dhe realizimit të punëve, adaptimeve në ndërtesën ekzistuese, projektimit dhe ndërtimit të objekteve të reja, futjes së instalimeve dhe të pajisjeve në ato objekte, eksploatimit dhe mirëmbajtjes së objekteve, aplikohen norma teknike dhe standardet për mbrojtje nga zjarri;

1.2. Ndërtesa duhet të jetë e pajisur me shkallë emergjente, të parapara për evakuim;

1.3 Ndërtesa duhet të jetë e pajisur me hidrantë, aparate për fikje të zjarrit, si dhe sistemin për alarmim. Numri, lloji dhe lokacioni i këtyre mjeteve, caktohet me normat dhe standardet e parapara teknike për mbrojtje nga zjarri;

1.4. Instalimet dhe pajisjet elektrike të ventilimit, të ngrohjes, të rrufepritisit, dhe të kanalizimit në ndërtesën e Kuvendit, vendosen në atë mënyrë që të mos paraqesin asnjë rrezik nga zjarri;

1.5. Përgjegjësit që kanë për detyrë mirëmbajtjen e instalimeve dhe pajisjeve të caktuara, kanë obligim që të bëjnë kontrollin e gjendjes teknike dhe të funksionimit të pajisjeve dhe instalimeve, në atë mënyrë që në rast të dëmtimit të tyre, të mos shkaktojnë zjarr në ndërtesë;

1.6. Në ndërtesën e Kuvendit, caktohet hapësira për vendosjen dhe ruajtjen e lëndëve djegëse dhe materialeve tjera, të cilat paraqesin rrezik për zjarr;

1.7. Shenjat e ndalimit duhet të vendosen në vend të dukshëm, ku theksohen vërejtjet përkatëse;

1.8. Puna me zjarr të hapur, me aparate për saldimit, prerje dhe ngjitje, mund të bëhet vetëm pasi të merret miratimi paraprak nga nëpunësi për mbrojtje nga zjarri, se janë marrë të gjitha masat e mbrojtjes nga zjarri dhe të jenë siguruar mjetet për shuarjen e tij;

1.9. Materialet e harxhuara, yndyrat, vajrat, ngjyrat, lecat, ambalazhet plastike, të drurit, si dhe materialet tjera të hedhura jashtë përdorimit, duhet të nxirren jashtë ndërtesës;

1.10. Deponimi i materialit në depo dhe hapësira tjera, bëhet në harmoni me dispozitat e legjisllacionit përkatës;

1.11. Mbushja e rezervarëve me lëndë djegëse duhet të bëhet në prezencën e përgjegjësit për mbrojtje nga zjarri;

1.12. Hapjet (kanalet) për drenazh duhet të kontrollohen rregullisht;

1.13. Në tavanet dhe nën kulmin e ndërtesës, ndalohet mbajtja e çfarëdo materiali apo pajisje, me përjashtim të pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit;

1.14. Lëndët djegëse dhe gazrat, nuk duhet të derdhën përmes rrjetit të kanalizimit;

1.15. Është i ndaluar riparimi i automjeteve jashtë lokacionit të paraparë.

1.16. Përdorimi i pajisjeve elektrike, furnelë elektrike, ngrohëse dhe bakal, rregullohet me akt të veçantë, i cili miratohet nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

2. Kryerja e punëve të rrezikshme që mund të nxisin zjarrin jashtë ndërtesës, që janë paraparë për qëllime të tilla, mund të lejohen vetëm me kushtin që paraprakisht të jenë marrë të gjitha masat për mbrojtje nga zjarri.

## **Neni 6**

### **Përdorimi i pajisjeve për mbrojtje nga zjarri**

1. Aparatet, pajisjet dhe mjetet e dedikuara për shuarjen e zjarrit, si dhe pajisjet e instalimet për lajmërim dhe sinjalizimin automatik të zjarrit në ndërtesën e Kuvendit, mund të përdoren vetëm kur përmbushen kriteret dhe standardet e parapara teknike ose pas marrjes së A-testit.

2. Aparatet, pajisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, vendosen në vende të dukshme, ku qasja është e lirë, në të gjithë ndërtesën e Kuvendit. Ato mund të shfrytëzohen vetëm për lokalizim dhe shuarje të zjarrit. Vendi në ndërtesë, ku ndodhen mjetet për shuarjen e zjarrit, shënohen me shenjë të dallueshme.

3. Aparatet, pajisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, si dhe pajisjet dhe instalimet për sinjalizimin dhe lajmërimin automatik të zjarrit, mbahen në gjendje të rregullt dhe për to mbahet evidencë e rregullt.

4. Kontrollimi i pajisjeve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit, instalimeve për sinjalizim dhe lajmërim automatik të zjarrit, duhet të bëhet çdo 6 (gjashtë) muaj dhe raporti me shkrim duhet të dorëzohet në Administratën e Kuvendit.

## **Neni 7**

### **Lëndimi në vendin e punës**

Lëndimi ose sëmundja, e cila shfaqet gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive për mbrojtje nga zjarri, trajtohet lëndim në punë sipas dispozitave të legjislationit përkatës.



## **Neni 8**

### **Trajnimi dhe aftësimi profesional**

1. Trajnimi i të punësuarve nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri, bëhet sipas programit, i cili hartohet dhe miratohet në bazë të kësaj Rregulloreje.
2. Programi për trajnim për mbrojtje nga zjarri hartohet nga DSHT, NJSPKQ - Policia e Kosovës në Kuvend dhe Drejtoria e Personelit.
3. Me përmbajtjen e programit, sigurohet fitimi i njohurive më elementare teorike dhe praktike për masat e mbrojtjes nga zjarri, si dhe për veprimin, në rast të paraqitjes së zjarrit, me: përmbajtjen e Ligjit për mbrojtje nga zjarri dhe të kësaj Rregulloreje dhe posaçërisht për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e punëtorëve, përdorimin e pajisjeve dhe të mjeteve për shuarjen e zjarrit.
4. Programi i trajnimit, mbështetet në shikimin e drejtpërdrejtë të burimeve të rrezikut dhe specifikave të procesit të punës, në vendet e caktuara të punës.
5. Masat e mbrojtjes nga zjarri që duhet të ndërmerren në vende pune.
6. Trajnimi bëhet përmes seminareve dhe ushtrimit praktik.

## **Neni 9**

### **Nëpunësi i ngarkuar për mbrojtje nga zjarri**

1. Në pajtim me nenin 7, paragrafi 1.4 dhe neni 8, paragrafi 2.4 të Ligjit nr. 04/L-012 për mbrojtje nga zjarri, nëpunësi i ngarkuar për mbrojtje nga zjarri, obligohet që të marrë pjesë, në:
  - 1.1. Trajnim themelor dhe plotësues; dhe,
  - 1.2. Ushtrime dhe forma të tjera të trajnimit praktik.
2. Zbatimi i obligimeve do të koordinohet përmes Drejtorisë së Shërbimeve Teknike dhe NJSPKQ - Policisë së Kosovës në Kuvend, dhe për këtë do t'i dorëzohet raport periodik, çdo gjashtë muaj sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

## **Neni 10**

### **Drejtorja për Shërbime Teknike**

1. Detyrat e Drejtorisë së Shërbimeve Teknike, janë:
  - 1.1. Hartimi i skemës dhe Planit të evakuimit për mbrojtje nga zjarri;
  - 1.2. Krijimi i sistemit për mbrojtje nga zjarri;
  - 1.3. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit të mbrojtjes nga zjarri.

2. Drejtoria e Shërbimeve Teknike, përkujdeset që objektivat e mbrojtjes nga zjarri të realizohen, si vijon:

2.1 Përkujdeset rreth gjendjes në ndërtesën e Kuvendit sipas rekomandimeve, të dhëna nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

2.2. Harton dhe zbaton plane për trajnime rutinore për mbrojtje nga zjarri;

2.3. Merr pjesë gjatë pranim - dorëzimit dhe testimit të sistemit për mbrojtje nga zjarri;

2.4 Është përgjegjëse për zbatimin e ligjit dhe rregulloreve për mbrojtje nga zjarri;

2.5 Është përgjegjëse për përpilimin e raportit të punës dhe të njëjtat t'i dërgojë me shkrim tek drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme për Administratë;

2.6 Raporton në rast të shkeljes së dispozitave të legjislacionit për mbrojtje nga zjarri.

### **Neni 11**

#### **Detyrat e organeve për mbrojtje nga zjarri**

1. Detyrat e NJSPKQ-së - Policisë së Kosovës në Kuvend, në fushën e mbrojtjes nga zjarri, janë:

1.1. Vështrimi, lajmërimi dhe alarmimi i punëtorëve të Kuvendit, për rastet e kërcënimit nga rreziku i shpërthimit të zjarrit;

1.2. Monitorimi i sistemit dhe mjeteve për alarmim 24/7;

1.3. Organizimi-funksionimi i ndërlidhjeve për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, në përputhje me sistemin unik të ndërlidhjes;

1.4 Bashkëpunimi me DSHT-në, për marrjen e masave për mbrojtje nga zjarri.

### **Neni 12**

#### **Evakuimi**

Evakuimi i punëtorëve bëhet nëse me masa të tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre.

**Neni 13**  
**Emërimi i komisionit vlerësues**

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, emëron Komisionin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri.

**Neni 14**

**Greva gjatë fatkeqësive që shkaktohen nga zjarri**

1. Të punësuarit nuk kanë të drejtë greve gjatë fatkeqësive, të cilat i shkakton zjarri dhe nëse është paralajmëruar rreziku nga fatkeqësitë natyrore.
2. Gjatë grevës nuk lejohet përdorimi i sinjaleve të alarmimit, si dhe i pajisjeve e mjeteve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

**Neni 15**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e publikimit në ueb faqen e Kuvendit.

Rregullore nr. 05/Rr - 001  
10 gusht 2016

Kadri VESELI,

  
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës